



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29625/26
Klinë, datë: 10, 09, 2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i trët publik për Draft-Buxhetin e vitev 2027 - 2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Grabanic, Bokshiq, Dollovë, Qeskov dhe Këpuz te komunës së Klinës, me, datë 28.08.2026, ora 18:00, në shkollen fillore "Azem Bejta" Grabanic.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 11 persona, prej të cilëve, 11 burra.

Shtojca 3 – Fotografi nga dëgjim i tretë për Draft-Buxhetin e vitev 2027- 2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave: Grabanic, Bokshiq Dollovë, Qeskovë, dhe Kepuzë te komunës së Klinës.



Fjala e Kryetarit të Komunës së Klinës, Prof Dr, Zenun Elezaj

Të nderuar banor te fshatrave Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, dhe Kepuzë të Komunës së Klinës,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve, organizatave, bizneseve, shoqërisë civile dhe të gjithë ju që keni marrë pjesë në këto dëgjime buxhetore,

Ju falënderoj sinqerisht për pjesëmarrjen dhe interesimin tuaj.

Sot kemi përpara një proces shumë të rëndësishëm për Komunën tonë: Prezantimin e Draft-Buxhetit Komunal për periudhën 2027–2029. Ky dokument nuk është vetëm një pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës. Buxheti është një plan konkret për zhvillimin e Klinës dhe për përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që ky proces të jetë sa më transparent, gjithëpërfshirës dhe i hapur për secilin qytetar.

Gjatë dëgjimeve buxhetore, ne kemi mundësinë të dëgjojmë nga afër kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e qytetarëve. Çdo mendim i paraqitur është i rëndësishëm dhe do të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit dhe finalizimit të buxhetit. Qëllimi ynë është që mjetet publike të orientohen aty ku nevojat janë më të mëdha dhe ku investimet sjellin ndikimin më të madh për qytetarët. Draft-Buxheti për vitet 2027–2029 synon të mbështesë prioritetet kryesore të Komunës sonë, duke përfshirë infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, zhvillimin ekonomik, bujqësinë, kulturën, rininë, sportin, shërbimet publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit dhe fshatrave tona një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve: përmirësimi të rrugëve dhe trotuareve, ujësjellësit dhe kanalizimit, ndriçimit publik, mirëmbajtjes së hapësirave publike, si dhe projekteve që krijojnë kushte më të mira për fëmijët, të rinjtë dhe familjet tona. Po ashtu, duam të vazhdojmë mbështetjen për bujqit, bizneset lokale dhe iniciativat që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Të nderuar qytetarë ne e dimë se nevojat e Komunës janë të shumta, ndërsa mundësitë buxhetore janë të kufizuara. Prandaj, sfida jonë është që të bëjmë zgjedhjet e duhura, të vendosim prioritete dhe të sigurohemi që çdo euro e buxhetit publik të shpenzohet me përgjegjësi dhe në interes të qytetarëve pikërisht për këtë arsye, dëgjimet publike janë shumë të rëndësishme. Ne nuk dëshirojmë që buxheti të jetë vetëm dokument i institucioneve, por të jetë rezultat i bashkëpunimit me qytetarët ju ftoj që të jeni aktivë, të paraqisni kërkesat tuaja, të jepni sugjerime konkrete dhe të kontribuoni në përcaktimin e prioritetëve për vitet e ardhshme. Ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim që Klina të jetë një komunë më e zhvilluar, më e mirë dhe me shërbime më cilësore për të gjithë qytetarët, pa dallim. Në fund, dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen, për bashkëpunimin dhe për kontributin tuaj në këtë proces, buxheti është i qytetarëve dhe duhet të ndërtohet me qytetarët ju faleminderit për vëmendjen dhe ju ftoj që tani të vazhdojmë me diskutimin, propozimet dhe kërkesat tuaja lidhur me Draft-Buxhetin e Komunës së Klinës për vitet 2027–2029.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Xhevat Thaqi: Bokshiq

Përshëndetje të gjithëve,

Kam disa kërkesa që dëshiroj t'i paraqes para jush në lidhje me problemet dhe nevojat e fshatit Bokshiq, veçanërisht në lagjen tonë, e cila njihet si Lagjja Gryka.

Problemi kryesor në lagjen tonë është furnizimi me energji elektrike (shtyllat), ku kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi probleme të shpeshta. Kërkojmë që kjo çështje të trajtohet dhe të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme një problem tjetër është emërtimi pasi mungesa e emrave të rrugëve krijon vështirësi për banorët dhe për shërbimet e ndryshme gjithashtu, disa nga rrugët e lagjes janë të dëmtuara. Kërkojmë që të bëhet një vlerësim i gjendjes së tyre dhe të ndërmerren masat e nevojshme për sanimin e pjesëve të dëmtuara një çështje tjetër thelbësore është uji i pijshëm furnizimi i rregullt dhe cilësor me ujë të pijshëm është një nevojë bazë për çdo familje dhe kërkojmë që edhe kjo problematikë të trajtohet me prioritet.

Pergjigja e Kryetarit:

Sa i përket emërtimit të rrugëve, kjo nuk paraqet problem duhet të bëhet një kërkesë në Kuvendin Komunal po ashtu, ekziston edhe komisioni i cili i shqyrton këto kërkesa, në pajtim me ju, banorët në këtë mënyrë mund t'i emërtojmë të gjitha rrugët edhe numrat e shtëpive I vendosim ndërsa, sa i përket pjesës së rrugëve të dëmtuara, ne e kemi në projekt që vitin e ardhshëm të intervenojmë në fshatrat Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Grabanicë, Kepuzë dhe në pjesët përreth, sa i përket demtimit të rrugëve kemi planifikuar që duke i rregulluar me një shtresë të re asfalti ose aty ku mund të ndërhyjmë përmes sanimit, do të bëjmë sanimin këtë e kemi paraparë në projekt dhe së shpejti do ta përfundojmë edhe procedurën përkatëse sa i përket ujit të pijshëm, po ashtu, në tri vitet e ardhshme do të ndërhyjmë edhe në këtë pjesë e kemi në plan të tona që të intervenojmë edhe te ujësjellësi, me qëllim që të gjejmë burime ku ka më shumë ujë pastaj, aty të hapim disa puse dhe ujin prej tyre ta dërgojmë në një pikë më të lartë, ku do të ndërtojmë edhe një rezervuar. nga ajo pikë do të mund të furnizohen me ujë edhe banorët e këtij vendi këto janë disa nga planet dhe angazhimet tona për përmirësimin e kushteve dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen banorët.

Zenel Mehemetaj, Bokshiq:

Kërkesat e mia për fshatin Bokshiq janë: Rregullimi i shtyllave dhe rrjetit elektrik zgjidhja e problemit me ujin e pijshëm rregullimi i kanalizimit sanimi i disa rrugëve që kanë pësuar dëmtime

Pergjigja e Kryetarit: Faleminderit shumë, Zenel.

Sa i përket ujit, e theksova edhe më herët se e kemi në planet tona të ndërhyjmë, vetëm se na duhet kohë për realizimin e tij, pasi ka një kosto goxha të lartë ne si komunë, realisht, qëndrojmë keq me buxhetin për investime, sepse po aty janë duke na ndikuar edhe lëndët përmbartimore që rrjedhin nga kontrata kolektive por qellimi yne është që dotë përkushtohemi që këtë projekt ta përfundojmë ndërsa, sa i përket shtyllave elektrike, kjo nuk është në kuadër të investimeve komunale megjithatë, përpjekjet tona do të jenë të vazhdueshme që të kontaktojmë zyrtarët përgjegjës të KEDS-it, në mënyrë që kërkesat tuaja të realizohen gjatë takimeve që mbajmë me KEDS-in, kërkesat tuaja do të jenë prioriteti kryesor sa i përket dëmtimit të rrugëve, gjatë këtyre tri viteve i kemi përfshirë në projekt për ri-asfaltimin me një shtresë të re asfalti. Po ashtu, aty ku mundemi, vetëm gropat e dëmtuara do t'i sanojmë.

Faleminderit për pyetjet tuaja dhe angazhimin maksimal!

Shkeqim Hasanai: Bokshiq

Kërkesa ime është që një firmë private, me kamionë të peshave të mëdha, ka dëmtuar një pjesë të rrugës shumë keq. Kisha pasur kërkesë, nëse është e mundur, të ndërhyjnë aty, sepse kemi vështirësi në kalimin në atë pjesë të rrugës.

Faleminderit, Shkelqim

Jam në dijeni për këtë rast dhe e di që inspektorati ka dalë në vendngjarje bashkë me policinë, duke bërë matjet e veta mirëpo do të dal këtë javë edhe unë në teren dhe do ta rregullojmë këtë problem menjëherë, sepse e di që ka qenë e vështirë të kalohet në atë pjesë të rrugës.

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 18:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	11
Totali	11

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

